



Prishtinë, 23 dhjetor 2016
Kodi i ZRRE-së: V_879_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15 dhe Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 4.2 dhe Nenit 22.2 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Dispozitat e Nenit 7.4 të Licencës së Operatorit të Tregut,

Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 09.12.2016 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit: Raporti i Derrogimeve për Kodin e Rrjetit, Rregullat e Tregut dhe Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit,

në seancën e mbajtur me datë 23.12.2016, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** kërkesa e KOSTT-it për **Derrogimet për Kodin e Rrjetit, Rregullat e Tregut dhe Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit** si në shtojcë të këtij vendimi.

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 09.12.2016 ka pranuar kërkesën e KOSTT-it për derrogim në zbatimin e disa dispozitave nga Kodi i Rrjetit, Rregullat e Tregut dhe Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit. Pas vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale në Sistemin e Transmisionit, Bordi i ZRRE-së ka parë të arsyeshme që të lejoj derrogim (shtyrje të afatit në zbatimin e dispozitave) të Kodit të Rrjetit, dispozitave të Rregullave të Tregut dhe dispozitave të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit në afatet e vendosura si në Shtojcë.

KOSTT ka dërguar në ZRRE një email në të cilin njofton për heqje nga derrogimi të nenit 12 të Rregullave të tregut dhe nenit 2.8 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit të cilat kanë të bëjnë me Mekanizmin Balancues, meqë ka filluar implementimi i këtij mekanizmi balancues Dry Run (kalkulim pa pagesë) nga tetori 2016, dhe është pritur që implementimi i plotë të filloi nga 01 janar 2017. Meqenëse implementimi i plotë është shty, atëherë është lejuar derrogimi edhe për këto



pika.

Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit mbesin në fuqi.

II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund ti drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Kopje: Raporti i Derogimeve për Kodin e Rrjetit, Rregullat e Tregut dhe Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit.

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së


Krenar Bujupi, u.d. kryesuesit


Arsim Janova, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar